



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:065959

Datë: 19.06.2019

Numri i dokumentit: 00365204

**PKR. nr. 71/18**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti për Krime të Rënda,** në trupin gjykues të përbërë nga Nikollë Komani, kryetar, Besarta Doli dhe Mentor Bajraktari anëtar të trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.J., Komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I nr. 75/2018 të datës 27.12.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datë 14.06.2019, në prezencën e prokurorit Ali Uka, të dëmtuarit S.A. dhe përfaqësuesit të tij të autorizuar N.D., avokat në Gjakovë, të dëmtuarit B.A., të akuzuarit A.J. dhe mbrojtësit të tij T.B., avokat në Gjakovë, me datë 18.06.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 19.06.2019 përpiloi këtë:

## **A K T G J Y K I M**

I akuzuari **A.J.**, i biri i Z. dhe R., e gjinisë H., data e lindjes..., në Gjakovë, i pamartuar, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim nga data 05.11.2018.

## **Ë S H T Ë F A J T O R**

**I. Sëpse** me datë 31.10.2018 në fshatin D., Komuna Gjakovë, pikërisht në afërsi të lokalit të dëmtuarit S.A. me dashje ka tentuar ta privojë nga jeta të dëmtuarin S., në atë mënyrë që ditën kritike rreth orës 15:00/h, i pandehuri A. shkon në lokalin e të dëmtuarit aty kanë qenë dy djemtë e të dëmtuarit B. dhe A.2. duke pastruar lokalin dhe me të dal nga lokali i tyre, i pandehuri A. kishte harruar telefonin e tij në lokal dhe B. merr telefonin e tij, i pandehuri me të hetuar se kishte harruar telefonin në lokal kthehet për ta marrur, aty vije gjerë te një fjalosje, e më pas rrahja ne mes të pandehurit A. dhe të dëmtuarit B., ashtu që më të kuptuar për rastin e ndodhur, i dëmtuari S. pas pak kohësh vije në vendin e ngjarjes nga qyteti i Gjakovës dhe aty për një moment i pandehuri A. nga brezi nxjerrë revolen e tipit walter kalibër 7.65 mm dhe me të njëjtën shtënë një herë në drejtim të viktimës, duke e qëlluar në pjesën e poshtme të

abdomenit (stomakut), përmbi organin gjenital dhe me atë rast i shkakton lëndim të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin, të konstatuar në raportin e ekspertit mjeko-ligjor dr. B.C. të datës 20.12.2018, e më pas i pandehuri menjëherë largohet nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur, ashtu që me datë 05.11.2018, i njëjti në mënyrë vullnetare paraqitet në polici rreth orës 17:00/h, gjersa i dëmtuari menjëherë dërgohet në emergjencën e Spitalit Rajonal "I.G." në Gjakovë, për ofrimin e ndihmës mjekësore.

- **me çka ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.**

## **ËSHTË FAJTOR**

**II. Sepse** me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e I-rë, të kësaj aktakuze me dashje i ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit B.A., Komuna Gjakovë, në atë mënyrë që i pandehuri shkon në lokalin e të dëmtuarit S.A., aty kanë qenë dy djemtë e të dëmtuarit S., i dëmtuari B. si dhe dëshmitari A. duke e pastruar lokalin dhe me të dal nga lokali i pandehuri vëren se e kishte harruar telefonin në lokal, kthehet për ta marrur dhe aty fillon një fjalosje, e më pas rrahje në mes të pandehurit A. dhe të dëmtuarit B., me ç' rast i pandehuri A. i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit B.A. me pasoja të përkohshme për shëndetin, lëndime këto të konstatuara në raportin e ekspertizës mjeko-ligjore të përpiluar nga dr. B.C. me datë 20.12.2018.

- **me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së.**

## **ËSHTË FAJTOR**

**III. Sepse** më parë ka siguruar e gjerë me datën 31.10.2018 pa autorizim ka mbajtur armë dhe municion dhe atë një revole të tipit walter kalibër 7.65 mm, si dhe një karikator së bashku me 6 fishek të të njëjtit kalibër, të cilën armë ditën kritike e ka përdorur në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, e cila armë është konfiskuar ditën kritike nga policia prej axhës së të pandehurit K.J.

- **me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.**

**Gjykata në bazë të nenit 6, 17, 41, 43, 45, 46, 73, 74, 75, 76, par. 1 nën par. 1.2, 80, 83, 178 lidhur me nenin 28, 188 par. 1 nën par. 1.4, 374 par. 1 të KPRK-së dhe nenit 233 dhe 365 të KPP-së, ia përcakton dënimet veç e veç:**

- për veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, të përshkruar në pikën e I-rë, të dispozitivit të aktgjykimit, dënim me burgim në kohëzgjatje 2 (dy) vite e 7 (shtatë) muaj;

- për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, të përshkruar në pikën e II-të, të dispozitivit të aktgjykimit, dënim me gjobë në shumën prej 300,00 € (treqind euro);

- për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, të përshkruar në pikën e III-të, të dispozitivit të aktgjykimit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj;

### **Gjykata bazuar në nenin 80 dhe 83 të KPP-së, e:**

## **G J Y K O N**

**Dënim** unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, e 10 (dhjetë) muaj, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 05.11.2018, si dhe **Dënim** me gjobë në shumën prej 300,00 € (treqind euro), të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në afatin prej 1 (një) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 ditëve duke ja llogaritur 20,00 € për një ditë burgimi.

Të dëmtuarit S.A.dhe B.A. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 200,00 €, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50,00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohet revolja e tipit walter kalibër 7.65 mm, një karikator dhe 6 fishek të njëjtit kalibër, si objekt i kryerjes së veprave penale.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën PP/I nr. 75/2018 të datës 27.12.2018, ka akuzuar A.J. nga fshati D., Komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, si dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Me datë 27.03.2019 i akuzuari A.J. dhe mbrojtësi i tij avokati F.B. me prokurorin Ali Uka, në prezencën edhe të përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit S.A., avokatit N.D. kanë arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë PP/I. nr. 75/2018.

Gjykata ka caktuar seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ku prezentë kanë qenë prokurori Ali Uka, i dëmtuari S.A. dhe përfaqësuesi i tij i autorizuar, avokati N.D., i dëmtuari B.A., i akuzuari A.J. dhe mbrojtësi i tij T.B. avokat në Gjakovë. Mbrojtësi i të akuzuarit, avokati T.B. ka theksuar se pas konsultimeve me të mbrojturin e tij janë dakorduar që seanca të vazhdoi me shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, duke shtuar se e ka lexuar marrëveshjen e arritur ku i pranishëm ka qenë një mbrojtës tjetër dhe pajtohet me marrëveshjen e arritur.

Me marrëveshjen PP/I nr. 75/2018 të datës 27.03.2019, për veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, palët janë pajtuar dhe i kanë propozuar gjykatës që të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, e 4

(katër) muaj, deri në 2 (dy) vite e 7 (shtatë) muaj, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, palët janë pajtuar dhe i kanë propozuar gjykatës që të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, deri në 5 (pesë) muaj, e për këto dy vepra penale janë pajtuar dhe i kanë propozuar gjykatës që të akuzuarit ti shqiptohet dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 10 (dhjetë) muaj, deri në 3 (tri) vite, ndërsa për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, palët janë pajtuar dhe i kanë propozuar gjykatës të akuzuarit të shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej 200,00 € deri në 400,00 €.

Prokurori Ali Uka ka deklaruar se në bazë të kërkesës gojore të parashtruar nga ana e ish mbrojtësit të akuzuarit A.J., avokatit F.B. të parashtruar në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.02.2019, kanë hyrë në negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, e me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, e natyrisht edhe të prokurorit me datë 27.03.2019 kanë arritur marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë konform dispozitave ligjore për kushtet dhe përmbajtjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. I akuzuari është njoftuar me të gjitha benifitet dhe pasojat nga marrëveshja për pranimin e fajësisë, andaj i propozon gjykatës që këtë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë të arritur me datë 27.03.2019 ta aprovoj si të bazuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit S. A., avokati N.D., lidhur me marrëveshjen e arritur ka theksuar se që nga fillimi i negociimit të kësaj marrëveshje nga ana e prokurorisë kanë qenë të njoftuar për çdo veprim procedural që ka të bëjë me marrëveshjen, ashtu që nuk e kanë kundërshtuar as atëherë, e nuk e kundërshtojnë as tani, pra pajtohen me marrëveshjen e arritur.

I dëmtuari S.A. ka theksuar se i mbështet në tërësi deklaramet e përfaqësuesit të tij të autorizuar.

I dëmtuari B.A. ka deklaruar se pajtohet me marrëveshjen e arritur.

Mbrojtësi i të akuzuarit, avokati T.B. lidhur me marrëveshjen e arritur ka deklaruar se i akuzuari ka kërkuar që të negociohet marrëveshja për pranimin e fajësisë në rend të parë duke pasur parasysh se ka qenë një incident i rastit, se me palën e dëmtuar është fqinjë, bashkëfshatar, kanë raporte solide në mes veti dhe ka qenë i interesuar që kjo çështje të mbyllet në këtë mënyrë, ashtu që i propozon gjykatës që të aprovet marrëveshja mbi pranimin e fajësisë.

I akuzuari A.J. ka deklaruar se e ka të qartë marrëveshjen e arritur, mbetet pranë marrëveshjes dhe deklarimeve të mbrojtësit të tij, duke shtuar se e pranon në tërësi fajësinë për veprat penale sipas aktakuzës.

Gjykata pas dëgjimit të pretendimeve të prokurorit, të dëmtuarve, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, lidhur me marrëveshjen për pranim të fajësisë ka konstatuar se i akuzuari A.J. e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë sipas marrëveshjes, pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe provat që i janë bashkangjitur aktakuzës, si dhe nuk ekziston asnjëra nga rrethanat për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale të parapara me nenin 253 par. 1 dhe 2 të KPP-së, andaj gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjor dhe është e bazuar në nenin 233 par. 21 të KPP-së dhe gjykata ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Gjatë seancës për caktimin e dënimit prokurori Ali Uka ka deklaruar se në mes të prokurorit të çështjes në njërin anë, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij F.B. në anën tjetër, e me të

cilën marrëveshje është pajtuar edhe mbrojtësi i tanishëm i të akuzuarit avokati T.B., janë pajtuar dhe dakorduar që të akuzuarit për veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, ti shqiptohet dënimi me burgim prej 2 (dy) vite e 4 (katër) muaj, deri në 2 (dy) vite e 7 (shtatë) muaj, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, deri në 5 (pesë) muaj, e për këto vepra penale kanë propozuar që dënimi unik me burgim të jetë prej 2 (dy) vite e 10 (dhjetë) muaj, deri në 3 (tri) vite, ndërsa për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, kanë propozuar që dënimi të jetë me gjobë në shumën prej 200,00-400,00 €. Ka theksuar se i propozon gjykatës që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim ne suaza të minimumit dhe maksimumit të dënimeve të propozuara.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit S. A., avokati N.D. lidhur me dënimet e parapara me marrëveshje ka theksuar se e mbështetë deklarimin e prokurorit sa i përket dënimeve të propozuara dhe nuk kanë kundërshtime.

I dëmtuari S.A. duke u deklaruar lidhur me dënimet e propozuara me marrëveshje ka theksuar se e mbështet fjalën e përfaqësuesit të tij të autorizuar dhe nuk i kundërshton dënimet e propozuara me këtë marrëveshje.

I dëmtuari B.A. duke u deklaruar lidhur me dënimet e propozuara me marrëveshje ka theksuar se nuk i kundërshton këto dënime të propozuara.

Mbrojtësi i të akuzuarit, avokati T.B. ka deklaruar se sa i përket dënimeve të parapara me marrëveshje ka propozuar që gjykata të ketë parasysh faktin se i akuzuari ka të kaluar të pastër kriminale, andaj janë të mendimit se edhe me shqiptimin e dënimeve minimale në kuadër të marrëveshjes do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

I akuzuari A.J. ka deklaruar se i ka të qarta dënimet e propozuara me marrëveshje dhe pajtohet me deklarimet e mbrojtësit të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të paraparë me nenin 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Përpos konstatimit për kryerjen e veprave penale në mënyrën, kohën dhe vendin si në dispozitivat e aktgjykimit nuk ka gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marrë parasysh pranimin e fajësisë, pendimin e tij, sjelljen korrekte gjatë seancës, jodenueshmërinë e tij të mëparshme, faktin se me palën e dëmtuar janë pajtuar, e të cilat rrethana lehtësuese kanë ndikuar që gjykata ti aplikoi dispozitat e zbutjes së dënimit bazuar në nenin 74, 75, 76 të KPP-së, sa i përket veprës penale të vrasjes në tentativë të përshkruar në pikën e I-rë, të dispozitivit të aktgjykimit dhe ta aprovoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë, e të akuzuarit sipas marrëveshjes së arritur ia ka shqiptuar dënimin nën kufirin e paraparë ligjor për këtë vepër penale, ashtu që të akuzuarin e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, e 10 (dhjetë) muaj, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 05.11.2018, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 300,00 €, me bindjen e plotë se këto dënime janë në harmoni me peshën e veprave penale, shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi që të dëmtuarit të udhëzohen në kontest civil për realizimin e kërkesë pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463 par. 2 të KPP-së, për faktin se edhe në marrëveshjen e arritur përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit ka deklaruar se sa i përket kompensimit të dëmit do ta realizojnë në procedurë tjetër.

Vendimi për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 200,00 €, është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2, nën par. 2.6 të KPP-së, si dhe shumën prej 50,00 € për kompensimin e viktimave të krimit është marrë bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/L-036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**PKR. nr. 71/18, datë 18.06.2019**

**Sekretarja juridike**  
**Mandushe Doli**

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari**  
**Nikollë Komani**

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afatin prej 15 ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.